

Prof. dr. Jusuf BAJRAKTARI

FJALA E HAPJES

**Zonja dhe Zotërinj të nderuar,
Studiues dhe mysafirë,**

Shënimi i 130-vjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit është ngjarje kombëtare me rëndësi shkencore e kulturore për Kosovën dhe shqiptarët. Ky eveniment i rëndësishëm sot merr dimensione të veçanta për gjithë shqiptarët sepse po mbahet në vitin e njohjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës, të marrjes së ftesës së Shqipërisë në NATO dhe vetëm pesë ditë para hyrjes në fuqi të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Organizimi i kësaj Konference shkencore, nga Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës dhe Instituti i Historisë Prishtinë, ka për qëllim prezantimin e njohurive dhe afirmimin e vlerësimeve të reja që në të kaluarën për shkak të mungesës së dokumenteve të publikuara dhe pengesave të gjurmimit të lëndës arkivore si dhe për shkak të njëtrajtshmërisë së mendimit shkencor të kushtëzuar nga sistemi monist dhe regjimet shtypëse kanë ndikuar dhe ngulfatur të vërtetën shkencore.

Konferenca shkencore "Lidhja Shqiptare e Prizrenit 1878 – 1881" synon të afirmojë të arriturat dhe kontributet shkencore të historianëve, studiuesve e dijetarëve të sotëm jo vetëm të botës

shqiptare por edhe atyre që vijnë nga SHBA, nga Vjena, Stambolli e Amani.

Kumtesat e paraqitura për këtë Konferencë kapin një gamë të gjerë interesimesh dhe sigurojnë qasje e këndvështrime të ndryshme. Pjesëmarrësit me punën dhe angazhimin e tyre shkencore, këto dy ditë, do të prezantojnë të dhëna, fakte dhe argumente që do të plotësojnë e thellojnë studimet për këtë ngjarje të madhe të historisë së popullit shqiptar.

Me shpresë së kontributi shkencor i pjesëmarrësve të kësaj Konference do të jetë një ecje e avancim i mëtutjeshëm i mendimit shkencor dhe bashkë me diskutimet që do të zhvillohen gjatë këtyre dy ditëve brenda një kohe të shkurtër do të përmbliidhen e të shtypen në një botim të veçantë.

Zonja dhe zotërinj të nderuar,

Me lejoni që në emër të Këshillit Organizues të falënderojë Presidentin e Republikës së Kosovës, Prof. dr. Fatmir Sejdiu për përkrahjen e pakursyer dhënë kësaj Konference nën patronatin e të cilit po zhvillohen të gjitha aktivitetet kushtuar këtij jubileu të rëndësishëm.

Në mënyrë të veçantë shprehë falënderimin dhe mirëseardhjen, në këtë Konferencë, studuesve nga SHBA, Evropa e rajoni dhe studuesve shqiptarë nga Shqipëria, Maqedonia, Mali i Zi dhe Kosova.

Ndjehem shumë i nderuar që para jush ti deklaroj të hapura punimet e Konferencës shkencore "Lidhja Shqiptare e Prizrenit 1878-1881" duke ju uruar punë të mbarë dhe të suksesshme.

Prishtinë, 10 qershor 2008